



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 120/10 prot.

Tiranë, më 05.11.2019

VENDIM
Nr.118, datë 05.11.2019

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 21, DATË 01.04.2019

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 21, datë 01.04.2019, “Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë për pajisjen me aktin përfundimtar të konfirmimit me shkrim, të statusit të nëpunësit civil, në fund të periudhës së provës, të nëpunësit *****”,

KONSTATOVA SE:

Nëpërmjet informacionit të ardhur nga nëpunësi ***** , regjistruar me nr. 120 prot., datë 01.02.2019, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është njohur me pretendimet e tij se, pas përfundimit të periudhës së provës, ai nuk është pajisur me aktin përfundimtar të deklarimit të statusit të nëpunësit civil, pavarësisht se është trajtuar si i tillë.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri, ka nisur hetimin administrativ për rastin, ku rezultoi se, punonjësi ***** , është nëpunës civil, me detyrë në pozicionin “Doganier, Zyra e Skanerit, Sektori i Kontrollit të Sigurisë, Dega Doganore Durrës”,Kategoria IV-a, (Kategoria C2). Në datën 20.05.2015, ai ka përfunduar me sukses programin e trajnimit të detyrueshëm për nëpunësit civil në periudhë prove, pranë Shkollës së Administratës Publike (ASP). Me plotësimin e afatit të provës, eprori direkt i tij, në datën 23.12.2015, ka kryer vlerësimin në fund të periudhës së provës, në nivelin 2 “mirë”.

Duke filluar që nga ky moment, nëpunësi ***** është trajtuar si nëpunës civil i konfirmuar, duke shërbyer në periudha të ndryshme, sipas nevojave të punës, në pozicione të ndryshme të nivelit ekzekutiv në DPD. Konkretisht, me Aktin nr. 5247 prot., datë 27.02.2015, të njësisë përgjegjëse, është miratuar transferimi i përkohshëm i tij, në

pozicionin “*Doganier/Klasifikimi/Vlerësim Fizik*”, në zyrën e Klasifikimit të Vlerësimit të Kontrollit Fizik”, pranë Degës së Doganës Tiranë.

Më tej, punonjësi ***** me Urdhrin nr. 12305 prot., datë 22.05.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave është transferuar në detyrën “*Doganier/Klasifikim/Vlerësim Kontroll Fizik*”, Zyra e Skanerit, në Degën Doganore Durrës, Kategoria C2.

Së fundi, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar; Kreut II, të Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”; Vendimit nr. 921, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për personelin e administratës doganore*”, i ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike në cilësinë e njësisë përgjegjëse, pas shqyrtimit të propozimeve të bëra nga Komisioni i Ristrukturimit të DPD-së, me Aktin nr. 626/165 prot., datë 07.02.2019, ka vendosur transferimin e përhershëm të nëpunësit ***** në pozicionin “*Doganier, Zyra e Skanerit, Sektori i Kontrollit të Sigurisë*”, Dega Doganore Durrës, Kategoria IV-a, (Kategoria C2).

Në përfundim të hetimit administrativ procesi është përmbyllur me Vendimin Nr. 21, datë 01.04.2019, “*Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë për pajisjen me aktin përfundimtar të konfirmimit me shkrim, të statusit të nëpunësit civil, në fund të periudhës së provës, të nëpunësit ******”, në të cilin është vendosur:

*“1. Të kërkoj nga Eprori Direkt i nëpunësit ***** të nxjerrë aktin e konfirmimit të statusit, në përfundim të periudhës së provës, duke finalizuar në këtë mënyrë procesin e konfirmimit të nëpunësit në shërbimin civil, dhe të administrohet në dokumentacionin e dosjes personale të këtij punonjësi, duke njoftuar për këtë veprim edhe të interesuarin.”*

Në vijim, me qëllim zbatimin e vendimit paralajmërues, nëpunësi ***** i është drejtuar disa herë institucionit të Komisionerit. Nga korrespondenca shkresore dhe dokumentacioni bashkëlidhur saj, konstatoj se, në zbatim të vendimit paralajmërues nr.21, datë 01.04.2019, të Komisionerit, eprori direkt i nëpunësit, Kryetari i Degës së Doganës Durrës, ka nxjerrë aktin administrativ Vendim “*Konfirmim i nëpunësit civil*”, nr. 7826/1 prot., datë 26.04.2019, përmes së cilit, është vendosur:

*“1. ***** konfirmohet “Nëpunës civil” në pozicionin Doganier, në Degën Doganore Durrës- Kategoria C2 (IV-a).”*

Në analizë të praktikës shkresore të këtij rasti, vërej se:

Duke qenë se struktura e administratës doganore është dinamike dhe rregullohet në mënyrë specifike me vendim të Këshillit të Ministrave, e konkretisht me Vendimin Nr. 921, datë 29.12.2014, “*Për personelin e administratës doganore*”, i ndryshuar, ku në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi (me ndryshimet e fundit të bëra me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 2, datë 08.01.2018), nuk ekzistojnë më emërtesat e pozicioneve për

nëpunësit e administratës doganore, por klasifikimi i tyre sipas sektorëve bëhet duke iu referuar kategorisë së nëpunësve. Aktualisht, “Sektori i Operacioneve Doganore në Terminalin e Trageteve, Anijeve”, Terminali i Trageteve ka në përbërjen e tij “Doganier”, Kategoria C2 (Kategoria IV a).

Në mbështetje të sa më sipër, gjykoj që akti nr. 7826/1 prot., datë 26.04.2019, me të cilin është bërë konfirmimi si nëpunës civil, në pozicionin “Doganier”, në Degën Doganore Durrës – Kategoria C2 (Kategoria IV-a), për nëpunësin ******, është në përputhje me përcaktimet ligjore e nënligjore në fuqi në momentin e nxjerrjes së aktit.

Për sa u parashtrua më sipër, arrij në përfundimin se nga ana e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është zbatuar rekomandimi lënë në Vendimin Nr. 21, datë 01.04.2019, “Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë për pajisjen me aktin përfundimtar të konfirmimit me shkrim, të statusit të nëpunësit civil, në fund të periudhës së provës, të nëpunësit *****”, të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 21, datë 01.04.2019, “Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë për pajisjen me aktin përfundimtar të konfirmimit me shkrim, të statusit të nëpunësit civil, në fund të periudhës së provës, të nëpunësit *****”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duke zbatuar rekomandimin e Vendimit Nr. 21, datë 01.04.2019.
3. Për këtë vendim të njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Tiranë, Departamenti i Administratës Publike, dhe nëpunësi *****.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha